



Datë: 11.06.2025
Numër Protokolli: 4242/2025

A.nr.663/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.663/2025, të datës 16.04.2025, të parashtruar nga ankuesja S.B, kundër organit të punësimit-Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.663/2025, e datës 16.04.2025, e parashtruar nga ankuesja S.B.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 595, i datës 20.03.2025 i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile S.B, (*referuar tutje ankuesja*), më datë 16.04.2025, fizikisht ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 16.04.2025, dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.663/2025, kundër Vendimit me numër protokolli 593, të datës 20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (tutje APRK), ndërsa kjo e fundit më datë 07.05.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2510/2025, të datës 16.04.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 595, të datës 20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2025; Procesverbalin e datës 08.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim; Përgjigjen në ankesë me Nr.Protokolli 663/2025; Akt Emërimi me Nr.Protokolli 130 i datës 28.12.2017; Formulari i përshkrimit të punës; E-maili i datës 23 dhjetor 2024; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për iniciimin e procedurës disiplinore; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; Vendimin me numër protokolli 595, të datës

20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; Kushtet e veqanta; Prokurimi; UA/2016-23-9156-2-1-1; Autoritet kontarkuese; Formular për dorëzimin e tenderit; Specifikimet teknike të detyrueshme Ankesi 1; Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; Deklaratë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; Përshkrimi i Çmimeve; Lista e Autoriteteve Kontraktuese Ankesi 7; Certificate e regjistrimit të biznesit me Nr. 810836083; Deklaratë e garantuesit; Vendimin i datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj për periudhën 17.03.2024 deri 16.04.2024; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.06.2024-16.07.2024; Urdhër pagesa e datës 11.09.2024; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Dicipinor; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; Vendimin i datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.03.2024 deri 16.04.2024; Libër raporti nga Internacional Security Associates SH.P.K; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor; E-maili i datës 06 janar 2025 lidhur me Njoftimin për shtyrje të afatit për procedurën diciplinor; Vendimin me numër protokolli 181 të datës 06.02.2025 për shtyrje të afatit për procedurën diciplinor ; Raporti për prezencën në punë për periudhën 22.07.2024 deri më 22.07.2024; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 22.01.2025; P; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 31.01.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 26.12.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 22.01.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 19 dhe 20.03.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 19 dhe 22.01.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 19 dhe 31.01.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 19 dhe 26.12.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 22.01.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 19 dhe 20.03.2025.; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Diciplinor; Vendimi me Nr. protokolli 596 i datës 20.03.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për mbajtjen e seancës më datë 08.01.2025; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Diciplinor; Vendimi me Nr. protokolli 597 i datës 20.03.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për mbajtjen e seancës më datë 08.01.2025; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Diciplinor; Vendimi me Nr. Protokolli 595 i datës 20.03.2025; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor; Dëftesa për pranim-dorëzimin e vendimeve të komisionit diciplinor; Vendimi me Nr. Protokolli 593 i datës 20.03.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025; E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për mbajtjen e seancës më datë 08.01.2025; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Diciplinor; Vendimi me Nr. protokolli 594 i datës 20.03.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 05.02.2025; E-maili i datës 31 janar 2025 lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 05.02.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 31.01.2025; E-maili i datës 28 janar 2025, ftesë për pjesëmarrje ; E-maili i datës 06 shkurt 2025, lidhur me shtyrën e afatit; Vendimi me Nr. Protokolli 181 i datës 06.02.2025; Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; Deklaratë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; Përshkrimi i Qmimeve; Lista e Autoriteteve Kontraktuese Ankesi 7; Certificate e regjistrimit me

nr.810836083;Deklarata e Garantuesit; Dëftesa për pranim-dorëzimin e vendimeve të komisionit disiplinor;Vendimi me Nr.protokolli 598 të datës 20.03.2025;Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025;E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor;Dëftesa për pranim-dorëzimin e vendimeve të komisionit disiplinor; Vendimi me Nr.Protokolli 594 i datës 20.03.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave;Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 08.01.2025;E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për mbajtjen e seancës më datë 08.01.2025;E-maili i datës 03 janar 2025 lidhur me Njoftimin për inicim të procedurës disiplinore dhe ftesë për pjesëmarrje në Komision Dicipinor; Procesverbali mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 31.01.2025; E-maili i datës 28 janar 2025 lidhur me lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 31.01.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me dërgimin e provave; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 05.02.2025; E-maili i datës 31 janar 2025 lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 05.02.2025; E-maili i datës 13 shkurt 2025;Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 31.01.2025;E-maili i datës 28 janar 2025, ftesë për pjesëmarrje ;E-maili i datës 06 shkurt 2025, lidhur me shtyrën e afatit; Vendimi me Nr. Protokolli 181 i datës 06.02.2025; Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421 dhe Aneksi 1;Deklaratë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421;Përshkrimi i Qmimeve;Lista e Autoriteteve Kontraktuese; Certifikata e regjistrimit me nr.810836083;Deklarata e Garantuesit; Dëftesa për Pranimin-Dorëzimin e Vendimeve të Komisionit Dicipinor;Vendimi me Nr. protokolli 598 i datës 20.03.2025;E-maili i datës 13 shkurt 2025 lidhur me sigurimin e provave më kërkesë të komisionit Dicipinor; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 27.01.2025;Raporti për prezencën në punë për periudhën 22.07.2024 deri më 22.07.2024;E-maili i datës 27 janar 2025 lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 27.01.2025;Vendim për vërejtje me shkrim me Nr. Protokolli 47 i datës 11.01.2024;E-maili i datës 11 janar 2024, konfirmim i pranimi të e-mailit; E-maili i datës 20 shkurt 2025 lidhur me vizitën në Zyrën e Punësimit; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 21.02.2025; Kërkesa nga Zyra e Punësimit me Nr. Protokolli 052 e datës 17.11.2023;E-maili i datës 18 shkurt 2025, Ftesë për pjesë marreje në takimin e organizuar nga Zv.Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë së Punësimit; E-maili i datës 20 shkurt 2025;E-maili i datës 24 shkurt 2025 i bashkangjitur Përcaktimi i Objektivave Vjetore; E-maili i datës 03 shkurt 2025, Kërkesa e Komisionit Disiplinor që të ju dërgohet komunikimi me Policinë e Kosovës; E-maili i datës 29 janar 2025, Ftesë në cilësinë dëshmitarit; E-maili i datës 28 janar 2025 lidhur me sigurimin e provave më kërkesë të komisionit Dicipinor; E-maili i datës 27 janar 2025 lidhur me sigurimin e provave të deklaruara; E-maili i datës 22 janar 2025 lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 27.01.2025;Libri Raporti Ditari i Punës nga Internacional Security Associates SH.P.K;E-maili i datës 24 shtator 2024; Kërkesa nga Zyra e Punësimit më Nr.Protokolli 052 i datës 17.11.2023;E-maili i datës 27 janar 2025 lidhur me sigurimin e provave të deklaruara; E-maili i datës 22 janar 2025 lidhur me ftesën për pjesëmarrje në seancën e radhës 27.01.2025. E-maili i datës 27 janar 2025 lidhur sigurimin e provës se deklaruar; E-maili i datës 06 shkurt 2025 lidhur me Kërkesën për sigurimin e provës për pranimin e shërbimit të pastrimit të datës 22.07.2024 të ZP-Ferizaj; Vendimin me numër protokolli 487 i datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes për periudhën kohore 12.06.2024 deri më 11.07.2024; E-maili i datës 20 shkurt 2025 lidhur me Kontratën Publike Kornizë Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421; E-maili i datës 20 shkurt 2025 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor lidhur me shpenzimet e bëra nga ZP -Ferizaj; Urdhër pagesë i datës 20.12.2024; Raportin mbi shërbimin e sigurimit të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj i datës 22.11.2024; Vendimin e datës 16.09.2024 për procedurat dhe përgjegjësit e pranimi të mallrave dhe shërbimeve në Zyrën e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimi Profesional; Urdhër pagës e datës 20.11.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.09.2024 deri 16.10.2024; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.09.2024 deri 16.10.2024; Urdhër pagesë

e datës 08.10.2024; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.08.2024 deri 16.09.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.08.2024 deri 16.09.2024; Urdhër për pagesë e datës 10.09.2024; Vendimin me numër protokolli 540 i datës 19.08.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.07.2024 deri 16.08.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.07.2024 deri 16.08.2024; Urdhër për pagës i datës 30.07.2024; Vendimin me numër protokolli 486 i datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.06.2024 deri 16.07.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.06.2024 deri 16.07.2024; Urdhër për pagesë e datës 27.06.2024; Vendimin me numër protokolli 341 i datës 20.05.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.04.2024 deri 16.05.2024;

Urdhër për pagës i datës 29.04.2024; Vendimin me numër protokolli 245 i datës 22.004.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.03.2024 deri 16.04.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.04.2024 deri 16.04.2024; Urdhër për pagës e datës 03.04.2024; Vendimin me numër protokolli 188 i datës 18.03.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.02.2024 deri 16.03.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.02.2024 deri 16.03.2024; Urdhër për pagesë e datës 06.03.2024; Vendimin me numër protokolli 111 i datës 21.02.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.01.2024 deri 16.02.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.01.2024 deri 16.02.2024; Urdhër për pagesë i datës 12.02.2024; Vendimin me numër protokolli 49 i datës 22.01.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.12.2023 deri 16.01.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.12.2024 deri 16.01.2024; Urdhër për pagesë e datës 26.12.2024; Vendimin me numër protokolli 731 i datës 18.12.20234 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.11.2023 deri 16.12.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që ankesa e ankueses është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 130 të datës 28.12.2017 është e punësuar në pozitën Udhëheqëse në Zyrën e Punësimit në Shtime, në kuadër të APRK-së.

Tutje Zyrtari përgjegjësi për Sinjalizim në kuadër të APRK-së, përmes emailit të datës 02.12.2024, ka paraqitur tek Drejtori i Përgjithshëm i APRK-së, rastin e sinjalizimit, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i APRK-së, më datë 23.12.2024, ka adresuar rastin në Komisionin Disiplinor të APRK-së.

Komisioni Disiplinor i APRK-së, më datë 20.03.2025, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 595, ku ka bërë përgjegjëse ankuesen për shkelje të rënda disiplinore dhe të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore *Ndalimi i pagës bazë në vlerën njëzet përqind (20%) për periudhën një (1) muaj.*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 595, të datës 20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të APRK, të cilin sipas librit të pranimi e ka pranuar më datë 14.04.2025, pretendon se nuk ka pasur asnjë obligim për zbatimin e kontratës së sigurimit fizik, dhe dokumenti është plotësuar siç ka ardhur nga Udhëheqësi i Zyrës. Komisioni Disiplinor ka bërë në mënyrë të gabueshëm deklaratat e ankueses ngase nuk janë marr për bazë asnjë rrethana lehtësuese duke mos shqyrtuar faktin se ndaj ankueses nuk është shqiptuar më parë masë disiplinore, ngase ankuesja nuk ka pasur qasje dhe po ashtu nuk ka qenë e njoftuar për ndërrim të orarit të sigurimit të objektit. Kërkon të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoj dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Nenit 56, paragrafi 1 dhe 4 me të cilin është përcaktuar se: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1.mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. **veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja**; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.*

-Nenit 57 paragrafi 2 : *“ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësve/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

-Nenit 58, paragrafit 2 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: *“Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.*

Kolegji i Këshillit, duke shqyrtuar të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha në tërësinë e saj, konstaton se Agjencia Qendrore e Prokurimit më datë 14.11.2023 ka lidhur Kontratë Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421 për shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të APRK-së në vlerën 124,862.88 Euro, ndërsa sipas Aneksit 1 lidhur me Specifikimet Teknike të Detyrueshme është përcaktuar orari i sigurimit fizik në kuadër të Zyrave të Punësimit dhe Qendrave të APRK-së, e meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me Zyrën e Punësimit në Ferizaj, sipas këtij aneksi është paraparë orari i punës prej orës 08-16. Rrjedhimisht për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit në Zyrën e Punësimit në Ferizaj, është emëruar edhe komisioni ad hoc, ku ankuesja ka qenë pjesë e këtij komisioni të përcaktuar sipas Vendimit me numër protokolli 540 të datës 19.08.2024, Vendimit me numër protokolli 486 të datës 22.07.2024, Vendimit me numër protokolli 341 të datës 20.05.2024, Vendimit me numër protokolli 245 të datës 22.04.2024, Vendimit me numër protokolli 188 të datës 18.03.2024, Vendimit me numër protokolli 111 të datës 21.02.2024, Vendimit me numër protokolli 49 të datës 22.01.2024, Vendimit me numër protokolli 731 të datës 18.12.2023, Vendimit me numër protokolli 487 të datës 22.07.2024, e për rrjedhojë ky komision sipas këtyre vendimeve pranon furnizimin apo shërbimin sipas plotësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në dispozita ligjore dhe sipas kërkesës për furnizim dhe komisioni obligohet të posedon dhe ta prezantoj-procesin fletë-pagesën e nënshkruar nga ky komision lidhur me pranimin e furnizimit me rastin e sjelljes së faturave për pagesë.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të çështjes, vlerëson se komisioni ad hoc i emëruar sipas vendimeve të cekura si më lartë ka bërë pranimin e shërbimit të sigurimit të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj, e kjo mund të vërtetohet sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të Zyrës së Punësimit në Ferizaj të datës 19.08.2024 për periudhën nga data 17.07.2024 deri më datë 16.08.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 22.07.2024 për periudhën nga data 17.06.2024 deri më datë 16.07.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 20.05.2024 për periudhën nga data 17.04.2024 deri më datë 16.05.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 22.04.2024 për periudhën nga data 17.03.2024 deri më datë 16.04.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 18.03.2024 për periudhën nga data 17.02.2024 deri më datë 16.03.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 21.02.2024 për periudhën nga data 17.01.2024 deri më datë 16.02.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 22.01.2024 për periudhën nga data 17.12.2023 deri më datë 16.01.2024, sipas raportit mbi shërbimin e sigurimit fizik të datës 18.12.2023 për periudhën nga data 17.11.2023 deri më datë 16.12.2023.

Rrjedhimisht në vazhden e shqyrtimit të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja në deklaratimet e saj në seancë të Komisionit Disiplinor më datë 08.01.2025 ka deklaruar se: *këtë veprim e ka bërë me mirëkuptim dhe mirëbesim duke u bazuar në përgjegjësinë e udhëheqësit Naim Gashi obligimet edhe sinqeritetin e tij...në pyetjen e komisionit disiplinor se: sipas raporteve të muajve dhjetor 2023, janar 2024, shkurt 2024, mars 2024, prill 2024, qershor 2024 dhe korrik 2024, ju keni pranuar shërbimin për sigurim fizik për Zyrën e Punës në Ferizaj. A janë të nënshkruar këto raport nga ju?, ankuesja është përgjigjur: të gjitha raportet e prezantuara nga komisioni janë të nënshkruara nga unë, pyetja e komisionit se: pse dhe në çfarë rrethane keni nënshkruara pranimin e shërbimit në fjalë, në raportin e Zyrës së Punësimit dhe në raportin e kompanisë duke marrë parasysh se ju nuk jeni pjesë e stafit të një zyreje ku ofrohet ky shërbim? ankuesja ka deklaruar: Unë kam pyetur N. se pse unë duhet të nënshkruaj at raport pasi që nuk jam pjesë e stafit të ZP Ferizaj dhe ai më ka thënë citoj: '' se nuk kam staf dhe nuk më lejohet'', ai ka thënë se citoj '' stafin e kam në pushim ''.....në pyetjen e komisionit disiplinor Për periudhat e lartcekura në të cilat keni nënshkruar raportet e pranimin të shërbimit, a ka pasur personel të sigurimit në objektin e Zyrës së Punësimit në Ferizaj?, ankuesja ka deklaruar unë nuk e di, nuk i njoh dhe nuk e di se a është kryer shërbimi..... pyetja e komisionit mbi çfarë baze ju keni vlerësuar dhe jeni siguruar se është ofruar ky shërbim në ZP në Ferizaj në muajin Qershor 2024? ankuesja ka deklaruar: Fatkeqësisht unë nuk kam vlerësuar as menduar mbi kryerjen e këtij në ZP Ferizaj, duke menduar dhe besuar në*

përgjegjësitë që ka udhëheqësi N.G. pyetja e komisionit: atëherë a keni qenë të ndikuar dhe imponuar për pranimin e këtij shërbimi nga Udhëheqësi Zyrës së Punësimit në Ferizaj, përkatësisht nga N.G? Ankuesja është përgjigjur: unë nuk e llogariti si trysni, sepse edhe takimi edhe kërkesa nga N.G i ka qenë krejtësisht në rrjedhë normale dhe kolegjiale gjithmonë me mirëbesim siç e thashë më lartë. Deklarata përmbyllëse e ankueses ishte... Unë nuk e llogariti se ka qenë, sepse edhe takimi edhe kërkesa nga N.G ka qenë krejtësisht në rrjedhë normale dhe kolegjiale gjithmonë me mirëbesim siç e thash më lartë.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, në këtë procedurë të vendosjes ka shqyrtuar edhe provat tjera materiale si procesverbalet e Komisionit Disiplinor me rastin e dëshmisë së anëtarëve të komisionit ad hoc për pranimin e Shërbimit të sigurimit fizik të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj, dhe të gjithë deklarojnë se për periudhën sipas raporteve të cekura si më lartë, nuk ka pasur sigurim fizik prej orës 08:00 deri në orën 16:00, duke deklaruar tutje se të gjitha raportet janë nënshkruar në bazë të deklaratave të Drejtorit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj cili ka deklaruar se merr përgjegjësin për ka garantuar se gjithçka ishte në rregull. Komisioni Disiplinor më datë 31.01.2025 në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar N.J përfaqësi i Inetratioanl Security Association SH.P.K, dhe i njëjti ka deklaruar: se më datë 17.11.2023 më ka kërkuar N.G Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Ferizaj që të është e mundur të më sillni sigurimin fizik pas orës 16:00 sepse jemi duke e parë më të arsyeshëm që me qenë sigurimi pas orës 16:00 deri në ora 24:00 dhe unë i kam kërkuar që më të dërgoj një shkresë zyrtare...ndërsa ndër të tjera ka deklaruar se ka përmbyllur kontratën mirëpo nëse i referohemi librit të raportit të punës nga kompania Internacionale Security Association SH.P.K, rezulton se nga data 17.11.2023 deri më datë 15.11.2024 sigurimi fizik është bërë nga ora 17:00 deri në orën 24:00.

Komisioni Disiplinor më datë 05.02.2025 në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar B.Z., Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Zyrën e Punësimit në Prishtinë. Njëjti ka deklaruar se asnjëherë nuk ka pranuar njoftim apo shkresë lidhur për sigurimi fizik të objekteve të APRK-së lidhur me ndryshimin e orarit për ofrim të këtij shërbimi nga ora 08:00 deri në ora 16:00 me ndryshimin nga ora 17:00 deri në ora 24:00.

Po ashtu në pyetjen në komisioni: Komisioni disponon një provë me Nr. Protokollit 652 të datës 17.11.2023 me Subjektin “kërkesë” e cila i është drejtuar përfaqësuesit të operatorit ekonomik Z. N.J përfaqësi i Inetratioanl Security Association SH.P.K nga Udhëheqësi i ZP FERIZAJ z. N.G , kjo kërkesë ka qëllimin e ndërrimit të orarit, citoj:’..., konsiderojë që është e nevojshme se sigurimi në ZP Ferizaj të bëhet pasdite duke e ndërruar orarin, cito:’... konsiderojë që është nevojshme se sigurimi në ZP në Ferizaj të bëhet pasdite duke ndërruar orarin nga ora 08:00-16:00 në orarin e pasdites nga 16:00-24:00 ku orë ore e pauzës mund të shfrytëzojë në fillim të orarit nga orar 15:00-17-00”.A keni qenë i njoftuar ju si menaxher i kontratës për një kërkesë të tillë?(Prezantohet prova nga komisioni, përkatësisht shkresa me Nr. të protokollit 652 datë 17.02.2023). Përgjigjja e dëshmitarit ishte :Jo, një provë të tillë unë po e shoh sot për herë të parë. Dhe deklarata përmbyllëse dëshmitarit ishte unë si menaxher i kontratës duke u mbështetur në vendimin nr.1349 të datës 15.11.2023, vendimit nr.365 dt.19.04.2019, provat e dorëzuar nga ZP dhe QAP, faturën tatimore të dorëzuar nga operatori ekonomik si dhe “lista e punëtorëve” nga ATK, për çdo muaj kam përpiluar raportin përfundimtar dhe kërkesën e cila më pas është përcjellur tek njësia përgjegjëse për ekzekutim të pagesave.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me numër protokolli 595, të datës 20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të APRK-së, konstaton se ankuesja përveç pranimin të shërbimit të sigurimit të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj në kundërshtim me Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421 për shërbimet e Sigurimit Fizik të Objekteve të APRK-së, institucioni në këtë rast APRK, edhe pse nuk ka marr shërbimet sipas kontratës së cekur më lartë, kompania e angazhuar sipas kontratës është paguar për shërbimin, e në këtë rast Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesja ka bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2,

nenin 55 dhe nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, e Vendimi me numër protokolli 593, i datës 20.03.2025 i Komisionit Disiplinor të APRK-së, është nxjerr në pajtim me afatet e përcaktuara me dispozitat e ligjit material, i njëjti është i ligjshëm pasi që është nxjerr në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ndërsa ankuesja pretendimet e saja nuk ka mundur ti argumentoj me prova materiale, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses ka marr parasysh nenin 61 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, që ka të bëjë me parimet e individualizimit të masave disiplinore.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.663/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses S.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APRK dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.